



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
Komiteti për Politikë dhe Financa  
01. Nr.06 061-9926 /2020  
Dt.07.05.2020

Për: z./znj. \_\_\_\_\_  
LËNDA: F T E S Ë

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e katërt për vitin 2020 të Komitetit për Politikë dhe Financa të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, e cila do të mbahet me dt. **14.05.2020 ( E Enjte )** me fillim në **ora, 10:00** në hapësirat e Pallatit të Kulturës , Salla e Vogël kati II .

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D I T E**

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 12.03.2020 .
2. Informata -I- Financiar Periodike 2020 .
3. Të Ndryshme .



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**z. Anton Shala**



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF  
KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës  
Komiteti për Politikë dhe Financa  
01 Nr.060/01-7752/2020  
Gjakovë, me dt.12.03.2020, ora 10:00  
Ndërtesa e Komunës në objektin e ish BANKOS-it

### PROCESVERBALI

**Nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2020 .**

Të pranishëm ishin këta anëtarë të KPF-së: z. Anton Shala, z. Haxhi Sejdiu, znj. Florentina Gjergjaj, z. Fazli Hoxha, z. Rrok Luli, z. Bekim Ermeni, znj. Kaltrina Biblekaj, znj. Mimoza shala .

Mungon : znj. Diana Qarkaxhia,

**Të pranishëm të tjerë:** z. Durim Halilaj, z. Kushtrim Brahimaj, përfaqësues nga ZKKK-së, zyrtar për informim, përfaqësues të OSBE-së dhe të OJQ-ve, media lokale: TV Syri, Radio Gjakova, dhe media të shkruara.

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: **z. Anton Shala .**

**Kryesuesi:** Të nderuar anëtarë të pranishëm të Komitetit për Politikë dhe Financa sot do ta kemi mbledhjen e tretë për vitin 2020 të KPF-së, të pranishëm në këtë mbledhje janë 8 anëtar 1 mungon , andaj meqenëse ekziston kuorumi po fillojmë sipas agjendës .

Për këtë mbledhje është propozuar rendi i ditës sipas ftesës të cilën e keni marrë a ka dikush ndonjë vërejtje apo sugjerim sa i përket rendit të ditës.

**z. Rrok Luli:** Në një përgjigjeje që e kemi marr nga kryetari dhe drejtori i shërbimeve Publike lidhur me kanalizimin e ujerave të zeza ka qenë shumë shqetësuese ku në mbledhjen e fundit të kuvendit drejtoi i shërbimeve Publike ka thënë se Komunës së Gjakovës i duhen edhe 10 vite për me i përmbyll kanalizimet andaj unë kërkoj që të kemi si pikë të veçantë diktimin për këtë çështje sepse kanalizimet në komunën e Gjakovës janë shumë shqetësues .

**znj. Mimoza Shala :** Propozoj që të kemi një pikë të rendit të ditës lidhur me projektin 100€ për fëmijët e porsalindur .

**Kryesuesi:** Mendoj se për këtë pikë fillimisht duhet të kemi konsultime paraprake me kryetarin dhe drejtorin e financave sepse e nuk e dimë se a jem ne kompetent për këtë çështje .

**z. Durim Halilaj :** Nëse kërkesa është për këtë vit atëherë buxheti është i miratuar dhe mjetet nuk janë të parapara .

**znj. Florentina Gjergjaj:** Unë propozoj që të kemi një hapësirë kohore që të konsultohemi edhe me natarët tjerë të grupeve dhe të marrim një qëndrim se si do të veprojmë sepse kjo erdhi si shpejtë në këtë takim

**Kryesuesi:** E qes në Votim rendin e ditës sipas ftesës së bërë, dhe me kërkesën e z. Rrok Luli: informatë për kanalizimet në Komunën e Gjakovës. Kush është : Pro, Kundër, Abstenim, nga anëtarët e pranishëm unanimisht u votua pro, pas votimit u miratua ky :

## **R E N D I T**

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 19.02.2020 .
2. Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2019, në buxhetin e vitit 2020.
3. Informata Financiare Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2019.
4. Raporti vjetor i punës së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Vitin 2019.
5. Informata për kanalizimet në Komunën e Gjakovës
6. Të Ndryshme .

**1.Pika e parë e rendit të ditës:** Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 19.02.2020

**Kryesuesi:** E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës a ka dikush ndonjë vërejtje.

**Kryesuesi:** Pasi që nuk ka diskutime e qes në votim, miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me dt. 19.02.2020 Kush është Për, Kundër, Abstenim.

Nga anëtarët e KPF-së unanimisht u votua por .

**2. Pika e dytë e rendit të ditës:** Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2019, në buxhetin e vitit 2020.

**Kryesuesi:** Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Bartja e të hyrave vetanake të pashpenzuara nga viti fiskal 2019, në buxhetin e vitit 2020, andaj e ftoj Drejtorin z. Durim Halilaj që ta merr fjalën .

**z. Durim Halilaj:** Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur propozimin për bartjen e mjeteve nga viti 2019 në buxhetin e vitit 2020 ku komunës së Gjakovës i kanë tepruar mjete në vlerë prej 817, 227€ po ashtu e kemi edhe tejkalimin e të hyrave vetanake në vlerë prej 422,436 euro , vlera e paraparë për bartje nga vitet paraprake në vitin 2020 janë në këto kategori ekonomik , paga dhe mëditje , mallra dhe shërbime , shpenzime komunale , subvencione dhe transfere , dhe projekte kapitale si dhe tejkalimi i të hyrave vetanake ku në total bartja është 1239,730,10€ bashkangjitur i keni të gjitha dokumentet kategoritë ekonomike nuk janë ndryshuar projektet që kanë qenë të nisura janë të buxhetuara .

**Kryesuesi:** Pasi që nuk ka diskutime tjera e qes në votim, që kjo pikë të kalojë për shqyrtim në mbledhjen e kuvendit, **Kush është Për, Kundër, Abstenim.** Nga anëtarët e KPF-së **unanimisht u votua pro**, pas votimit të bërë komiteti për Politik dhe Financa e miratojë këtë :

## **P ë r f u n d i m**

- I. Aprovohet Informata mbi suksesin e gjysmë vjetorit të parë shkollor 2019-2020 .

II. Kjo pikë së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës .

### 3. Pika e tretë e rendit të ditës : Informata Financiare Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2019.

**Kryesuesi:** Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Informata Financiare Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2019. andaj e ftoj Drejtorin z. Durim Halilaj që ta merr fjalën

**z. Durim Halilaj:** Duke u bazuar në nenin 46 pika 1 dhe 46 pika 2 të ligjit për menaxhimin e financave Publike për raportimet e përkohshme dhe vjetore Drejtoria për buxhet dhe financa e ka përgatitur informatën financiare për vitin 2019, kjo informatë ka për qëllim të tregoj të gjithë treguesit relevantë për Komunën e Gjakovës planifikimin, realizimin, shpenzueshmërin, alokimin si dhe treguesit tjerë financiar, Buxheti fillestar ka qenë në vlerë prej 24.785,17€ i cili ka pësuar ndryshime me bartjen nga viti paraprak në vlerë prej 1.998,980€, nga donacionet dhe participimet dhe donacionet në vlerë prej 371,631€ bartje nga vitit paraprak 1.833.4746,€ , buxheti total i komunë së Gjakovës ka qenë 26, 784,€53 dhe nuk përfshihet tejkalimi i të hyrave vetanake , ku shpenzueshmëria ka qenë 96% , kategoritë ekonomike që janë shpenzuar janë paga dhe mëditje janë shpenzua 99.64% e mjeteve të planifikuara, tek mallra dhe shërbime janë shpenzuar 97%, tek shpenzimet komunale janë shpenzuar 94%, tek subvencionet dhe transferet janë shpenzuar 94% tek investimet kapitale janë shpenzuar 90,6% po ashtu komuna ka mbledh të hyra vetanake në vlerë prej 3.917.450€ që përbën 12% tejkalim të planifikimit , për herë të parë komuna e gjakove kalon në 975,000€ borxhe nuk ka vlera milionëshe borxhe .

**znj. Florentina Gjergaj:** Tek pagesat e subvncioneve në analitik janë të paraqitura totali i vlerës në drejtori por meqenëse tabela lexohet horizontalisht lexohet në total andaj kjo duhet të përmirësohet .

**z. Rrok Luli:** Tek të hyrat e realizuara sipas drejtorive ka realizmi mbi planifikimin deri në 182% pse ka ndodh kjo a është bërë planifikimi i dobët apo pse ka ndodh kjo.

**z. Durim Halilaj:** Planifikimi i të hyrave punohet së bashku me Ministrin e Financave, disa të hyra nuk mund të parashikohen siç janë dënimet e inspektorit si dhe në tatim në pronë ka borxhe të grumbulluara, tejkalimi ka ndodhur për shkak të punësës mirë të stafit të komunës .

**z. Bekim Ermeni:** Ajo që është më rëndësi në këtë raporte janë investimet kapitale në faqe 20 realizimi i buxhetit në investime kapitale është 90.6% sipas raportit i bazuar në totalin e alokimit dhe në totalin e realizimit i cili nuk korrespondon me faqen 3 qe po ashtu flitet për investimet kapitale por në bazë të grandeve të të hyrave sepse kemi të hyra vetanake mjetet e bartura dhe grande e donacione dhe nëse i shikojmë përqindjet në faqen 3 mesatarja del 83.6 % , pra këto dy shifra nuk korrespondojnë në mënyrë veti .

Në pjesën analitike ku shqetësuese janë mjetet e shpenzuara nga vendimet e gjykatave dhe në nenin 39 që ka të bëjë me thesarin, ku qeverisja nuk arrin me i kryer obligimet ndaj operatorëve ekonomik dhe operatorët ekonomik detyrohen ti marrin mjetet përmes përmbarueseve dhe kjo tregon një menaxhim jo të mitre të parësë . Tek shpenzimet analitike të paraqitura në këtë raport ku janë paraqitur disa projekte si Hartat Zonale Komunale ku janë planifikuar , janë alokuar dhe janë hargjuar mjetet , si dhe kodi për ndërtimin e pandave të ujitej 50,000€ janë planifikuar, 50,000€ janë alokuar dhe 50,000€ të hargjuara si dhe blerja e pajisjeve fotografuese XXL selfi dhe ballkoni panoramik ku janë planifikuar 20,000€ janë alokuar dhe janë shpenzuar , ndërtimi dhe vendosja e pajisjes roler zip linë janë planifikuar janë alokuar dhe janë hargjuar si dhe kërkoj sqarime për programin e bashkëpunimit ndërkombëtar Kosovë dhe Mali i Zi .

Kërkoj që në mbledhjen e radhës në mënyrë zyrtare për këto 4 projekte kapitale të na sjellësh në kopje fizike , raportin e menaxherit të projektit , raportin e kompanisë mbikëqyrëse , dhe urdhërpagesën nga njësit kërkuese për pagesën ndaj operatorit ekonomik për këto projekte .

**z. Durim Halilaj:** Tek shpenzueshmëria e investimeve kapitale për herë të parë Komuna e Gjakovës e ka shpenzueshërinë në investime kapitale mbi 90% , shpenzimet kapitale u tha se nuk përputhen unë po ju sqaroj se përputhen sepse grani qeveritarë është më i madhe se dhe është i saktë janë llogaritur me fri ballans. Tek borxhet dënimet dhe gjykata Drejtoria për buxhet dhe financa të gjitha projekte kanë qenë të alokuara dhe vlera e thesarit kanë qenë obligime ndaj operatorëve ekonomik , ndërsa gjykata kanë qenë për lëndët kontestuese që kanë qenë në gjykatë dhe të gjitha kanë qenë lëndë të viteve paraprake . Sa i përket kodeve që i përmend për Hartën Zonale janë tërhequr nga thesari , Blerja e pajisjeve janë tërhequr nga thesari dhe në të gjitha ato që i përmende janë tërhequr nga thesari e nuk janë shpenzuar për këto projekte , për projektin emalit të zi liderë ka qenë komuna e malit të zi

**znj. Kaltrina Biblekaj:** Tek qiraja për tregjet në të gjitha vitet janë realizuar të hyra ndërsa për vitin 2019 nuk janë inkasuar pse ka ndodhur kjo a nuk janë inkasuar a mjetet kërkojmë sqarime .

**z. Durim Halilaj:** Tregjet nuk kanë pasur kontratë në vitin 2019 dhe tani janë në procedurë të ankandit publik , ndërsa mjetet që janë inkasuar në vitet e kaluara kanë qenë obligime ndaj komunës .

**Kryesuesi:** Pasi që nuk ka diskutime tjera e qes në votim, që kjo pikë të kaloj për shqyrtim në mbledhjen e kuvendit, **Kush është Për, Kundër, Abstenim.**

Nga anëtarët e KPF-së **unanimisht u votua pro kësaj pike**, pas votimit të bërë komiteti për Politik dhe Financa e miratoj këtë :

### **P e r f u n d i m**

**I.** Aprovohet Informata Financiare Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2019.

**II.** Kjo pikë së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës .

**4. Pika e katërt e rendit të ditës :** Raporti vjetor i punës së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Vitin 2019.

**Kryesuesi:** Për këtë pikë të renit të ditës e kemi Raporti vjetor i punës së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Vitin 2019, andaj e ftoj z. Kushtrim Brahimaj që ta merr fjalën .

**z. Kushtrim Brahimaj :** Qëllimi i këtij raporti është rritja e transparencës komunale , Komuna e Gjakovës i ka rreth 322 pozita të autorizuar prej tyre 321 janë t karrierës dhe vetëm një është jo i karrierës ky është një raport 6 majorësh sepse përshaka të ndryshimeve ligjore nuk kemi pas mundësi të zhvillojmë konkurse , Realizimi i planit të punës për vitin 2019 ka arritur në 72% për këto 6 muaj . Pasojat e kësaj janë edhe në shtimin e numrit në shtrues të detyrës kryesisht në pozitat udhëheqëse edhe sot e kësaj dite ende nuk mundemi të procedojmë me konkurse .

**z. Bekim Ermeni:** Raporti është i detajuar por kërkoj disa sqarime shtesë lidhur me disa paqartësi ku e kamë një kërkesë që të plotësohet ky raport edhe me disa të dhëna me listën e të punësuarave të shërbyesve civil vetëm gjatë vitit 2019, lista e të angazhuarve me kontratë mbi vepër duke e specifiku edhe detyrat e punës dhe kërkojmë një listë të zyrtarëve komunal të cilëve me vendim të kryetarit të komunës i është rritë koeficienti i pagës nëse ka .

**z. Haxhi Sejdiu:** Për pikën e parë të ngritur nga z. Ermeni , kurë janë konkurset publike dhe janë të publikuara në faqen Zyrtare mendoj se është e pa nevojshme me hap debat por kjo është kërkesë politike , ndërsa për këto dy kërkesat tjera mendoj se duhet të sqarohen .

**z. Kushtrim Brahimaj;** Nuk ka kompetencë kryetari i Komunës me i ngrit koeficientet e zyrtarëve pa konkurs, pra nuk ka asnjë rritje të koeficienti por kemi në bazë të konkurseve dhe ka pasur rregullime. Për listën e marrëveshjeve me shërbime të veçanta i kemi për dy arsye sepse i kemi 40 vende të lira të punës sot që në një formë jemi duke i mbuluar me shërbime të veçanta dhe arsyeja e dytë është ku disa shërbime janë të afatsëhme dhe nga DUMM kemi marrë kërkesën për angazhimin e disa zyrtarëve për shërbime të caktuara . Për listën e të punësuarve nuk është as një problem ato janë publike andaj më duhet një konsultë me ministri dhe nuk paraqet problem .

**Kryesuesi:** Pasi që nuk ka diskutime tjera e qes në votim që kjo pikë të kaloj për shqyrtim në mbledhjen e kuvendit, **Kush është Për, Kundër, Abstenim.**  
Nga anëtarët e KPF-së **unanimisht** u votua pro kësaj pike.

### **P e r f u n d i m**

**I.** Aprovohet Raporti vjetor i punës së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Vitin 2019.

**II.** Kjo pikë së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës .

**6. Pika e gjashtë e rendit të ditës :** Informatë lidhur me gjendjen e kanalizimeve në Komunën e Gjakovës

**Kryesuesi:** Për këtë pikë të rendi të ditës e kemi Informatë lidhur me gjendjen e kanalizimeve në Komunën e Gjakovës të cilën e kërkoj z. Rrok Luli të cilin e ftoj që ta merr fjalën .

**z. Rrok Luli:** Unë kërkoj një informatë lidhur me planet e kësaj qeverisje për kanalizimet në komunën e Gjakovës sepse është shumë e nevojshme investimi në kanalizime e jo të pritët 10 vite siç u tha në mbledhjen e kuvendit .

**z. Haxhi Sejdiu:** Ne kemi kërkuar këtë informatë nga kryetari dhe përgjigjeje është se në vitin 2021 do të ketë fonde të mëdha për investime në kanalizime .

**z. Durim Halilaj:** Unë vetëm dua të ju sqaroj se Kanalizimet nuk janë aset i komunës, Bashkimi evropian do të ndaj fonde për trajtimin e ujerave të zeza

**Kryesuesi:** Pasi që nuk ka diskutime tjera e qes në votim, që kjo pikë të kaloj për shqyrtim në mbledhjen e kuvendit, **Kush është Për, Kundër, Abstenim.**  
Nga anëtarët e KPF-së **unanimisht** u votua pro kësaj pike.

### **P e r f u n d i m**

**I.** Aprovohet Informatë lidhur me gjendjen e kanalizimeve në Komunën e Gjakovës

**II.** Kjo pikë së bashku me materialin dhe dokumentin e përgatitur të përcillet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Kuvendit të Komunës .

## **7. Pika e shtatë e rendit të ditës: Të ndryshme**

**Kryesuesi:** Unë dua të konsultohemi me të gjithë ju sepse ashtu siç e dini Organizata Botërore e Shëndetësisë ka shpallur Pandemi në nivel botëror, andaj për këto pikat e financave sidomos për bartjen a ka ndonjë afat të caktuar sepse mundet me ndodh që të shtyhet mbledhja .

Ju rikujtoj edhe një herë se e keni obligim ashtu siç jeni informuar edhe nga Zyra e personelit që të bëni deklarinimin e pasurisë sipas afateve ligjore .

**Kryesuesi :** A ka dikush ndonjë diskutim për këtë pikë , Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja u shpall e mbyllur në ora 11:20

Procesmbajtës,

Burim Bajrami

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



---

## KOMUNA E GJAKOVËS

# INFORMATA E -I- PERIODIKE FINANCIAR

Për vitin fiskal 2020

Gjakovë, Prill -2020

# Informata -I- Financiar Periodike 2020

## Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunal për periudhën Janar – Mars 2020, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë” dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunal Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.

## TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP të bazuar në para të gatshme “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”. Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Komuna e Gjakovës nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Gjakovës janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i nxjerrë nga Asambleja Komunale dhe i aprovuar me ligjin e Buxhetit Nr.07/L-001 në vlerë **27.252.717,00€** i cili ka pësua ndryshime gjatë periudhe Janar–Mars 2020 për të hyrat nga donacionet dhe participimet në vlerë **75.356,87€**. Buxheti i përgjithshëm Periodik për këtë periudhë është **27.328.073,87€**.

|                                    |                      |
|------------------------------------|----------------------|
| <b>Buxheti Fillestar</b>           | <b>27,252,717.00</b> |
| Grandi qeveritar                   | 23,530,350.00        |
| Te hyrat vetanake                  | 3,722,367.00         |
| Financim nga Huamarrja             |                      |
| <b>NDRYSHIMET BUXHETORE</b>        | <b>75,356.87</b>     |
| Mjetet e bartura nga viti paraprak |                      |
| Participimet dhe Donacionet        | 75,356.87            |
| Zvoglim ne Financim nga Huamarrja  |                      |
|                                    |                      |
| <b>BUXHETI MOMENTAL</b>            | <b>27,328,073.87</b> |

### Raport i ekzekutimit të Buxhetit


|                              |          | Buxheti fillestar    | Periodik             | Pranimet -<br>Alokimet | Pagesat<br>(Shpenzimi) | Progresi<br>me plan | % me<br>alokim |
|------------------------------|----------|----------------------|----------------------|------------------------|------------------------|---------------------|----------------|
| Përshkrimi                   |          | Ligji Nr. 07/L-001   | SIMFK                | SIMFK                  |                        | në, %               | në, %          |
| a                            |          | b                    | c                    | d                      | e                      | f=e/c               | g=e/d          |
| <b>Gjithsej Pagesat</b>      |          | <b>1+2+3+4</b>       | <b>1+2+3+4</b>       | <b>1+2+3+4</b>         | <b>1+2+3+4</b>         |                     |                |
|                              |          | <b>27,252,717.00</b> | <b>27,328,073.87</b> | <b>7,250,416.57</b>    | <b>4,338,314.08</b>    | <b>15.87%</b>       | <b>59.84%</b>  |
| <b>HUAMARRJET</b>            | <b>1</b> | <b>-</b>             | <b>-</b>             |                        |                        |                     |                |
| HUAMARRJET M&SH              |          |                      |                      |                        |                        |                     |                |
| HUAMARRJET KAPITALE          |          |                      |                      |                        |                        |                     |                |
| <b>Granti i Përgjithshëm</b> | <b>2</b> | <b>23,530,350.00</b> | <b>23,530,350.00</b> | <b>7,175,059.70</b>    | <b>4,338,314.08</b>    | <b>18.44%</b>       | <b>60.46%</b>  |
| Paga dhe Meditje             |          | 13,795,893.00        | 13,795,893.00        | 3,425,799.23           | 3,425,799.23           | 24.83%              | 100.00%        |
| Mallrat dhe Shërbimet        |          | 2,508,103.00         | 2,508,103.00         | 1,254,051.50           | 655,705.27             | 26.14%              | 52.29%         |
| Shpenzimet Komunale          |          | 544,800.00           | 544,800.00           | 272,400.00             | 104,880.45             | 19.25%              | 38.50%         |
| Subvencione dhe Transferet   |          | 42,500.00            | 42,500.00            | 21,250.00              |                        | 0.00%               | 0.00%          |
| Investimet Kapitale          |          | 4,403,118.00         | 4,403,118.00         | 2,201,558.97           | 151,929.13             | 3.45%               | 6.90%          |
| Rezervat                     |          | 2,235,936.00         | 2,235,936.00         |                        |                        |                     |                |
| <b>Të hyrat vetanake</b>     | <b>3</b> | <b>3,722,367.00</b>  | <b>3,722,367.00</b>  | <b>-</b>               | <b>-</b>               | <b>0.00%</b>        | <b>#DIV/0!</b> |
| Paga dhe Meditje             |          | 22,000.00            | 22,000.00            |                        |                        | 0.00%               | #DIV/0!        |
| Mallrat dhe Shërbimet        |          | 496,000.00           | 496,000.00           |                        |                        | 0.00%               | #DIV/0!        |
| Shpenzimet Komunale          |          | 42,000.00            | 42,000.00            |                        |                        | 0.00%               | #DIV/0!        |
| Subvencione dhe Transferet   |          | 468,000.00           | 468,000.00           |                        |                        | 0.00%               | #DIV/0!        |
| Investimet Kapitale          |          | 2,694,367.00         | 2,694,367.00         |                        |                        | 0.00%               | #DIV/0!        |
| <b>Mjetet e bartura</b>      | <b>4</b> | <b>-</b>             | <b>-</b>             | <b>-</b>               | <b>-</b>               | <b>#DIV/0!</b>      | <b>#DIV/0!</b> |
| Paga dhe Meditje             |          |                      |                      |                        |                        | #DIV/0!             | #DIV/0!        |
| Mallrat dhe Shërbimet        |          |                      |                      |                        |                        | #DIV/0!             | #DIV/0!        |
| Shpenzimet Komunale          |          |                      |                      |                        |                        | #DIV/0!             | #DIV/0!        |
| Subvencione dhe Transferet   |          |                      |                      |                        |                        | #DIV/0!             | #DIV/0!        |
| Investimet Kapitale          |          |                      |                      |                        |                        | #DIV/0!             | #DIV/0!        |
| <b>Grantet - Donacionet</b>  | <b>5</b> | <b>-</b>             | <b>75,356.87</b>     | <b>75,356.87</b>       | <b>-</b>               | <b>0.00%</b>        | <b>0.00%</b>   |
| Paga dhe Meditje             |          |                      | 3,367.96             | 3,367.96               |                        | 0.00%               | 0.00%          |
| Mallrat dhe Shërbimet        |          |                      | 8,720.89             | 8,720.89               |                        | 0.00%               | 0.00%          |
| Shpenzimet Komunale          |          |                      |                      |                        |                        |                     |                |
| Subvencione dhe Transferet   |          |                      | 2,959.45             | 2,959.45               |                        | 0.00%               | 0.00%          |
| Investimet Kapitale          |          |                      | 60,308.57            | 60,308.57              |                        | 0.00%               | 0.00%          |
| <b>Pagesat Direkte</b>       | <b>6</b> | <b>-</b>             | <b>-</b>             | <b>-</b>               | <b>-</b>               | <b>#DIV/0!</b>      | <b>#DIV/0!</b> |

## ALOKIMET – PRANIMET PERIODIKE BUXHETORE 2020

Alokimet (Pranimet) Periodike buxhetore 2020, si dhe pranimet buxhetore për vitet paraprake  
Tabela - 2

| Burimi i mjeteve  | Pranimet Periodike 2017 | Pranimet Periodike 2018 | Pranimet Periodike 2019 | Pranimet Periodike 2020 | Progresi 20/19 | Progresi 20/18 |
|-------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|-------------------------|----------------|----------------|
| 1                 | 2                       | 3                       | 4                       | 5                       | 6=5/4          | 7=5/3          |
| Grandi Qeveritar  | 6,454,807.95            | 5,868,688.52            | 6,404,609.46            | 7,175,059.70            | 112.03%        | 122.26%        |
| Të hyrat vetanake | 435,779.06              | 483,667.92              | 393,721.06              |                         | 0.00%          | 0.00%          |
| Mjetet e Bartura  |                         |                         |                         |                         | #DIV/0!        | #DIV/0!        |
| Donacionet        | 246,431.72              | 115,395.42              | 307,999.32              | 75,356.87               | 24.47%         | 65.30%         |
| Gjithsej          | 7,137,018.73            | 6,467,751.86            | 7,106,329.84            | 7,250,416.57            | 102.03%        | 112.10%        |

GRAFIKONI I BURIMEVE FINANCIARE KOMUNALE (% E PJESMARRJES)




❖ Në këtë periudhë vjetore % e pranimeve financiare (të hyrave) duket si vijon:

- Alokimet nga të hyrat e Grandi përbëjnë, 98,96% te mjeteve financiare
- Alokimet nga të hyrat Komunale nuk kemi, mos aprovimi i Buxhetit nga Kuvendi i Kosovës
- Alokim nga të hyrat nga donacionet 1,04%

### TË HYRAT – ALOKIMET PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË

| Klasifikimi ekonomik  | 2016               | 2017               | 2018               | 2019               | 2020               |
|-----------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|--------------------|
|                       | BKK                | BKK                | BKK                | BKK                | BKK                |
|                       | €                  | €                  | €                  | €                  | €                  |
| Pagat dhe rrogat      | 3,242,808          | 3,201,645          | 3,296,300.52       | 3,405,175.11       | 3,425,799.23       |
| Mallrat dhe shërbimet | 593,710            | 873,134            | 716,410.00         | 838,583.37         | 1,254,051.50       |
| Shërbimet komunale    | 222,260            | 216,901            | 201,949.00         | 170,842.98         | 272,400.00         |
| Subvencionet & Trans. | -                  | -                  | -                  | -                  | 21,250.00          |
| Shpenzimet kapitale   | 1,673,000          | 2,163,128          | 1,654,029.00       | 1,990,008.00       | 2,201,558.97       |
|                       | <b>5,731,777.8</b> | <b>6,454,808.0</b> | <b>5,868,688.5</b> | <b>6,404,609.5</b> | <b>7,175,059.7</b> |


## TË HYRAT – ALOKIMET PERIODIKE NGA GRANTI I QEVERISË NE FORMË GRAFIKONI



### TË HYRAT VETANAKE PERIODIKE 2020

Përveç Grandeve të marra nga niveli qendror, për qëllimet e shpenzimeve të përgjithshme, Komuna ka grumbulluar edhe të hyra vetanake. Ekzistojnë disa kategori kryesore të hyrave vetanake komunale: tatimin në pronë, gjobot e trafikut, Kompensimi për rregullimin e tokave ndërtimore, shërbimet e kadastrave, dënimet nga Gjykata etj.... Të hyrat totale vetanake të grumbulluara Janar-Mars 2020 kanë arritur në shumën prej **714.836,41€** që përbën **103,11%** të planifikimit periodik (**693.257,78€**) **ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2019 kemi 105,19%**

### GRAFIKONI I TË HYRAVE VETANAKE PËRIODIKE 2016 - 2020




## PASQYRAT E TË HYRAVE VETANAKE SIPAS DREJTORIVE

| Nr        | PËRSHKRIMI                       | Realizimi<br>2016 | Realizimi<br>2017 | Realizimi<br>2018 | Realizimi<br>2019 | Realizimi<br>2020 | Planifi.<br>2020 | Progr. me<br>plan | Progresi<br>me 2019 |
|-----------|----------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|------------------|-------------------|---------------------|
|           |                                  | 1                 | 2                 | 3                 | 4                 | 5                 | 6                | 7=5/6             | 8=5/4               |
| <b>1</b>  | <b>PLANIFIKIMI URBAN</b>         | <b>49,647.8</b>   | <b>58,753.6</b>   | <b>141,673.9</b>  | <b>36,420.2</b>   | <b>134,949.08</b> | <b>94,900.0</b>  | <b>142.2%</b>     | <b>370.5%</b>       |
| a         | Rregullimi i tokës ndërtimore    | 39,134.4          | 52,875.4          | 131,313.38        | 32,552.53         | 121,944.14        | 65,000.00        | 187.6%            | 374.6%              |
| b         | Taksa urbanistike te ndryshme    | 2,156.2           | 1,090.0           | 1,748.96          | 660.00            | 661.00            | 7,000.00         | 9.4%              | 100.2%              |
| c         | Taksa per hapsires publike       | 8,357.2           | 4,788.2           | 8,611.60          | 3,207.70          | 1,573.16          | 7,000.00         | 22.5%             | 49.0%               |
| d         | Qeraja ne urbanizem              |                   |                   |                   |                   |                   | 3,900.00         | 0.0%              | #DIV/0!             |
| e         | Taksat nga trajt I ndert pa leje | -                 | -                 | -                 | -                 | 10,770.78         | 12,000.00        | 89.8%             | #DIV/0!             |
| <b>2</b>  | <b>SERBIMET PUBLIKE</b>          | <b>4,075.0</b>    | <b>2,158.0</b>    | <b>11,028.0</b>   | <b>24,778.0</b>   | <b>5,713.00</b>   | <b>8,748.00</b>  | <b>65.3%</b>      | <b>23.1%</b>        |
| a         | Terheqja e Automjeteve           | -                 | -                 |                   |                   |                   |                  | #DIV/0!           | 0.0%                |
| b         | Të hyrat nga parkingjet          | -                 | -                 |                   |                   |                   |                  | 0.0%              | 0.0%                |
| c         | Leje për taxi -e autobusëve      | 430.0             | 745.0             | 430.00            | 565.00            | 696.00            | 1,248.00         | 55.8%             | 123.2%              |
| d         | Të hyrat nga tregjet             | 3,645.0           | 1,413.0           | 10,598.00         | 24,213.00         | 5,017.00          | 7,500.00         | 66.9%             | 20.7%               |
| e         | Të hyrat nga shitjet automj.     |                   |                   |                   |                   |                   |                  | #DIV/0!           |                     |
| <b>3</b>  | <b>INSPEKSIONI</b>               | <b>7,482.7</b>    | <b>14,205.8</b>   | <b>16,108.3</b>   | <b>18,012.8</b>   | <b>25,206.58</b>  | <b>15,575.00</b> | <b>161.8%</b>     | <b>139.9%</b>       |
| a         | Denimet nga inspek.veterina      | -                 | 4,400.0           | 1,580.00          | 5,376.50          | 7,314.34          | 3,387.00         | 216.0%            | 0.0%                |
| b         | Lejet për kushte sanitare..      | 6,512.7           | 7,005.8           | 11,148.29         | 7,956.25          | 14,442.24         | 8,239.00         | 175.3%            | 181.5%              |
| c         | Taksa për pije alkoholike        | 970.0             | 2,800.0           | 3,380.00          | 4,680.00          | 3,450.00          | 3,949.00         | 87.4%             | 73.7%               |
| <b>4</b>  | <b>AGROKULTURA</b>               | <b>21,970.7</b>   | <b>17,490.2</b>   | <b>14,628.5</b>   | <b>13,638.5</b>   | <b>11,142.25</b>  | <b>11,000.00</b> | <b>101.3%</b>     | <b>81.7%</b>        |
| a         | Shendr. tokës bujq.-jo bujq.     | 21,970.7          | 17,490.2          | 14,628.50         | 13,638.50         | 11,142.25         | 11,000.00        | 101.3%            | 81.7%               |
| c         | Taksa-vertetima komunal          |                   |                   | -                 | -                 |                   |                  | #DIV/0!           | 0.0%                |
| <b>5</b>  | <b>KADASTRA</b>                  | <b>32,840.5</b>   | <b>41,362.4</b>   | <b>38,709.5</b>   | <b>26,736.5</b>   | <b>29,453.00</b>  | <b>35,334.78</b> | <b>83.4%</b>      | <b>110.2%</b>       |
| a         | Shërbimet kadastrale             | 32,840.5          | 41,362.4          | 38,709.50         | 26,736.50         | 29,453.00         | 35,334.78        | 83.4%             | 110.2%              |
| b         | Ekspertiza                       | -                 | -                 | -                 | -                 |                   |                  | #DIV/0!           |                     |
| <b>6</b>  | <b>ZHVILLIMI EKONOMIK</b>        | <b>9,125.4</b>    | <b>9,135.5</b>    | <b>12,595.0</b>   | <b>12,729.0</b>   | <b>8,497.00</b>   | <b>16,900.00</b> | <b>50.3%</b>      | <b>66.8%</b>        |
| a         | Taksa mbi biznesin               | 8,245.4           | 8,935.5           | 12,395.00         | 12,729.00         | 7,497.00          | 16,000.00        | 46.9%             | 58.9%               |
| b         | Vazhdimin e orarit të punës      | 880.0             | 200.0             | 200.00            | -                 | 1,000.00          | 900.00           | 111.1%            | #DIV/0!             |
| <b>7</b>  | <b>ADMINISTRATA</b>              | <b>27,213.0</b>   | <b>26,456.5</b>   | <b>28,050.5</b>   | <b>32,525.0</b>   | <b>23,909.5</b>   | <b>34,540.0</b>  | <b>69.2%</b>      | <b>73.5%</b>        |
| a         | Qertifikatat lindjes,vdekj.kuro. | 21,180.0          | 21,139.0          | 24,238.5          | 26,772.5          | 19,547.0          | 28,290.0         | 69.1%             | 73.0%               |
| b         | Qertifikatat tjera               | 2,260.0           | 5,317.5           | 3,812.0           | 2,039.00          | 1,344.00          | 1,950.00         | 68.9%             | 65.9%               |
| c         | Legalizim i ankesave shkres.     | 3,773.0           | -                 |                   | 3,713.50          | 3,018.50          | 4,300.00         |                   | 0.0%                |
| <b>8</b>  | <b>BUXHET E FINANCA</b>          | <b>312,489.1</b>  | <b>294,483.2</b>  | <b>327,187.3</b>  | <b>292,745.2</b>  | <b>267,466.2</b>  | <b>378,600.0</b> | <b>70.6%</b>      | <b>91.4%</b>        |
| a         | Qeraja për lokalet               | 2,343.0           | 340.0             | 2,270.0           | 8,210.00          | 2,120.00          | 11,000.00        | 19.3%             | 0.0%                |
| b         | Tatimi mbi pronën                | 276,655.7         | 259,030.6         | 287,083.6         | 246,309.46        | 232,992.15        | 331,100.00       | 70.4%             | 94.6%               |
| c         | Rexhistrimin e automjeteve       | 33,490.4          | 35,112.6          | 37,833.7          | 38,225.70         | 32,354.00         | 36,500.00        | 88.6%             | 84.6%               |
| <b>9</b>  | <b>ARSIMI</b>                    | <b>50,019.0</b>   | <b>65,912.5</b>   | <b>44,943.5</b>   | <b>66,920.99</b>  | <b>72,052.95</b>  | <b>73,160.00</b> | <b>98.5%</b>      | <b>107.7%</b>       |
| <b>10</b> | <b>KULTURA</b>                   | <b>5,129.0</b>    | <b>4,156.0</b>    | <b>4,497.0</b>    | <b>4,425.00</b>   | <b>3,795.00</b>   | <b>7,000.00</b>  | <b>54.2%</b>      | <b>85.8%</b>        |
| <b>11</b> | <b>SHENDETËSIA</b>               | <b>14,455.5</b>   | <b>13,558.0</b>   | <b>16,153.0</b>   | <b>14,824.50</b>  | <b>23,961.90</b>  | <b>17,500.00</b> | <b>136.9%</b>     | <b>161.6%</b>       |
|           | <b>TOTALI I TE HYRAVE</b>        | <b>534,447.7</b>  | <b>547,671.6</b>  | <b>655,574.5</b>  | <b>543,755.6</b>  | <b>606,146.4</b>  | <b>693,257.8</b> | <b>87.4%</b>      | <b>111.5%</b>       |
| <b>12</b> | <b>Denuimet traf.nga MEF-i</b>   | <b>29,578.0</b>   | <b>68,227.5</b>   | <b>79,816.0</b>   | <b>121,429.50</b> | <b>101,020.00</b> | <b>-</b>         | <b>#DIV/0!</b>    | <b>83.2%</b>        |
| <b>13</b> | <b>Te hyrat nga gjykata</b>      | <b>30,255.0</b>   | <b>18,915.00</b>  | <b>13,505.0</b>   | <b>13,155.00</b>  | <b>7,670.00</b>   | <b>-</b>         | <b>#DIV/0!</b>    | <b>58.3%</b>        |
| <b>14</b> | <b>Te hyrat nga Pylltaria</b>    | <b>-</b>          | <b>-</b>          | <b>-</b>          | <b>-</b>          | <b>-</b>          | <b>-</b>         | <b>0.0%</b>       | <b>0.0%</b>         |
|           | <b>TOTALI ME GJYKATA</b>         | <b>594,280.7</b>  | <b>634,814.1</b>  | <b>748,895.5</b>  | <b>678,340.13</b> | <b>714,836.41</b> | <b>693,257.8</b> | <b>103.11%</b>    | <b>105.38%</b>      |
|           | Donacionet -Participimet         | 39,009.2          | 12,466.2          | 67,700.0          | 2,657.2           | 1,501.7           | -                |                   | 0.0%                |
|           | <b>TOTALI ME PARTICIPIME</b>     | <b>633,289.9</b>  | <b>647,280.4</b>  | <b>816,595.5</b>  | <b>680,997.3</b>  | <b>716,338.2</b>  | <b>693,257.8</b> | <b>103.33%</b>    | <b>105.19%</b>      |

Periudha Janar-Mars 2020 karakterizohet me një realizimi i të hyrave në total 714836,41€ apo 103,33% në raport me planifikimin, ndërsa krahasuar me vitin paraprak 2019 kemi realizuar 105,19%

## TË HYRAT E REALIZUARA SIPAS DREJTORIVE

| DREJTORIT                  | Realizimi 2016    | Realizimi 2017    | Realizimi 2018    | Realizimi 2019    | Realizimi 2020    | Planifikimi 2020  | Progr. me plan | Progresi me 2019 |
|----------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|-------------------|----------------|------------------|
|                            | 1                 | 2                 | 3                 | 4                 | 5                 | 6                 | 7=5/6          | 8=5/4            |
| Urbanizmit                 | 49,647.76         | 58,753.58         | 141,673.94        | 36,420.23         | 134,949.08        | 94,900.00         | 142.2%         | 370.5%           |
| Shërbimet Publike          | 4,075.00          | 2,158.00          | 11,028.00         | 24,778.00         | 5,713.00          | 8,748.00          | 65.3%          | 23.1%            |
| Inspektionit               | 7,482.72          | 14,205.80         | 16,108.29         | 18,012.75         | 25,206.58         | 15,575.00         | 161.8%         | 139.9%           |
| Agrikulturës               | 22,476.24         | 17,490.20         | 14,628.50         | 13,638.50         | 11,142.25         | 11,000.00         | 101.3%         | 81.7%            |
| Kadastra                   | 32,840.50         | 41,362.40         | 38,709.50         | 26,736.50         | 29,453.00         | 35,334.78         | 83.4%          | 110.2%           |
| Zhvillimit Ekonomik        | 9,125.40          | 9,135.50          | 12,595.00         | 12,729.00         | 8,497.00          | 16,900.00         | 50.3%          | 66.8%            |
| Administrata               | 27,213.00         | 26,456.50         | 28,050.50         | 32,525.00         | 23,909.50         | 34,540.00         | 69.2%          | 73.5%            |
| Buxhet e Financa           | 312,489.12        | 294,483.19        | 327,187.26        | 292,745.16        | 267,466.15        | 378,600.00        | 70.6%          | 91.4%            |
| Arsimi                     | 50,019.00         | 65,912.47         | 44,943.47         | 66,920.99         | 72,052.95         | 73,160.00         | 98.5%          | 107.7%           |
| Kultura                    | 5,129.00          | 4,156.00          | 4,497.00          | 4,425.00          | 3,795.00          | 7,000.00          | 54.2%          | 85.8%            |
| Shëndetësia                | 14,455.50         | 13,558.00         | 16,153.00         | 14,824.50         | 23,961.90         | 17,500.00         | 136.9%         | 161.6%           |
| Dënimet traf. MEF-i        | 29,578.00         | 68,227.50         | 79,816.00         | 121,429.50        | 101,020.00        |                   | #DIV/0!        | 83.2%            |
| Te hyrat nga gjykata       | 30,255.00         | 18,915.00         | 13,505.00         | 13,155.00         | 7,670.00          |                   | #DIV/0!        | 58.3%            |
| <b>GJITHËSEJT</b>          | <b>594,786.24</b> | <b>634,814.14</b> | <b>748,895.46</b> | <b>678,340.13</b> | <b>714,836.41</b> | <b>693,257.78</b> | <b>103.1%</b>  | <b>105.4%</b>    |
| Participimet               | 39,009.16         | 12,466.22         | 67,700.00         | 2,657.16          | 1,501.74          | -                 |                | 56.5%            |
| <b>Gjithsej me Partic.</b> | <b>633,795.40</b> | <b>647,280.36</b> | <b>816,595.46</b> | <b>680,997.29</b> | <b>716,338.15</b> | <b>693,257.78</b> | <b>103.3%</b>  | <b>105.2%</b>    |




Siç shihet nga tabela, Drejtorit që grumbullojnë më së shumti të hyra janë: Buxhet e Financa 37,34% pastaj Urbanizmi 18,84%, dënimet ne trafik 14,10%, Arsimi 10,06%, Kadastra 4,11%, Administrata 3,34%, Shendetsia 3,35% etj...

## SHPENZIMET BUXHETORE 2020

Buxheti periodik (Janar Mars - 2020) është **27.328.073,87€**, gjatë kësaj periudhe buxhetore janë alokuar mjete në vlerë **7.250.416,57€**, ndërsa janë shpenzuar **4.338.314,08€**, apo **59,84%** e buxhetit të alokuar.

### Struktura e shpenzimeve

| Përshkrimi        | Realizimi<br>2016   | Realizimi<br>2017   | Realizimi<br>2018   | Realizimi<br>2019   | Realizimi<br>2020   | Alokimet 2020       | Progresi %    |               |
|-------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------|---------------|
|                   | 1                   | 2                   | 3                   | 4                   | 5                   | 6                   | 7=5/4         | 8=5/6         |
| Pagat             | 3,244,807.76        | 3,201,795.01        | 3,296,300.52        | 3,433,981.61        | 3,425,799.23        | 3,429,167.19        | 99.76%        | 99.90%        |
| Mallra e shërbime | 473,410.93          | 480,339.94          | 501,040.61          | 720,804.67          | 655,705.27          | 1,262,772.39        | 90.97%        | 51.93%        |
| Shpenzi. komunale | 154,595.14          | 128,304.24          | 169,711.39          | 133,335.82          | 104,880.45          | 272,400.00          | 78.66%        | 38.50%        |
| Subvencione       | 19,383.80           | 6,875.00            | 27,898.00           | 13,070.00           | -                   | 24,209.45           | 0.00%         | 0.00%         |
| Shpenzi. Kapitale | 705,084.98          | 980,533.04          | 737,392.66          | 535,353.31          | 151,929.13          | 2,261,867.54        | 28.38%        | 6.72%         |
| <b>Totali</b>     | <b>4,597,282.61</b> | <b>4,797,847.23</b> | <b>4,732,343.18</b> | <b>4,836,545.41</b> | <b>4,338,314.08</b> | <b>7,250,416.57</b> | <b>89.70%</b> | <b>59.84%</b> |



- **Pagat dhe mëditjet**

Mjete e alokuara-pranuara në vlerë 3.429.167,19€ janë shpenzuar vlerë 3.425.799,23€ apo 99,90% mjeteve të alokuara, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak shpenzimi është ~ barabartë. Pjesëmarrja e pagave në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 78,97,%

- **Mallrat & shërbimet**

Mjete e alokuara-pranuara në vlerë 1.262.772,39€ janë shpenzuar 655.705,27€ në përqindje 51,93% e mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin paraprak kemi 90,97% apo 9,03% me pakë. Pjesëmarrja e M & Shërbimeve në shpenzimin e përgjithshëm Komunal është 15,11 %.

- **Komunalit**

Mjete e alokuara-pranuara në vlerë 272.400,00€ janë shpenzuar 104.880,45€ ose në shkallën prej 38,50% të mjeteve të alokuara, krahasuar me vitin paraprak kemi zvogëlim për 21,34% apo. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në shpenzimin total komunal është 2,42%.

- **Subvencionet**

Mjete e alokuara-pranuara në vlerë 24.209,45€ nuk kemi shpenzim

- **Shpenzimet kapitale**

Mjete e alokuara-pranuara në vlerë 2.261.867,54€ kemi një shpenzim prej 151.929,13€ apo në përqindje 6,72% mjeteve të alokuara, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kemi shpenzime 28,38% të vitit 2019 apo 71,62% më pakë. Pjesëmarrja e Shpenzimeve kapitale në shpenzimin total Komunal është 3,50%.

- **Në total Buxheti i alokuar është shpenzuar për këtë periudhë 59,84% të mjeteve, krahasuar me periudhën e vitit paraprak shpenzimet janë 89,70% apo me të vogla për 10,30%.**

# SHPENZIMET NË ANALITIK 2015-2019 DHE PROGRESI ME 2 VITET E FUNDIT

| Përshkrimi                         | Mars 2016           | Mars 2017           | Mars 2018           | Mars 2019           | Mars 2020           | Krahasimi me 2019 | Krahasimi me 2018 |
|------------------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|-------------------|-------------------|
| Paga neto                          | 2,770,015.15        | 2,732,610.77        | 2,806,332.17        | 2,924,434.85        | 2,910,966.35        | 99.5%             | 103.7%            |
| Sindikata -0.1% te 0.50%           | 13,345.57           | 13,148.76           | 15,381.22           | 20,647.26           | 21,207.72           | 102.7%            | 137.9%            |
| Tatimi në paga                     | 153,269.54          | 151,711.92          | 161,088.07          | 166,111.68          | 168,135.92          | 101.2%            | 104.4%            |
| Kontributi i puntorve              | 154,088.75          | 152,161.78          | 156,749.53          | 161,393.91          | 162,744.62          | 100.8%            | 103.8%            |
| Kontributi i Punëdhënësit          | 154,088.75          | 152,161.78          | 156,749.53          | 161,393.91          | 162,744.62          | 100.8%            | 103.8%            |
| <b>TOTALI</b>                      | <b>3,244,807.76</b> | <b>3,201,795.01</b> | <b>3,296,300.52</b> | <b>3,433,981.61</b> | <b>3,425,799.23</b> | <b>99.8%</b>      | <b>103.9%</b>     |
| Mëditjet në Vend                   | 142,445.28          | 66,151.62           | 78,278.96           | 123,118.68          | 180.00              | 0.1%              | 0.2%              |
| Mëditjet Jashtë Vendi              | 1,991.85            | 5,673.86            | 1,765.88            | 2,612.03            | 1,260.00            | 48.2%             | 71.4%             |
| Shpenzimet e internetit            | 1,071.48            | 1,094.02            | 1,603.69            | 965.43              | 1,269.95            | 131.5%            | 79.2%             |
| Shpenzimet e telefonis mobile      | 9,452.85            | 3,506.14            | 2,162.17            | 2,284.69            | 173.53              | 7.6%              | 8.0%              |
| Shpenzimet Postare                 | 10,201.00           | 13,866.00           | 4,731.64            | 1,282.10            | 2,519.60            | 196.5%            | 53.3%             |
| Shërbime shtypjes-jo marketing     |                     |                     |                     |                     | 5,282.00            |                   |                   |
| Shërbime kontraktuese tjera        | 66,325.34           | 184,063.52          | 126,384.43          | 259,713.23          | 309,898.75          | 119.3%            | 245.2%            |
| Shërbime teknike                   | 2,638.60            | 1,657.90            | 4,190.00            | 5,539.36            | 4,368.32            | 78.9%             | 104.3%            |
